



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I MINISTRAVE
KËSHILLI KOMBËTAR I TERRITORIT DHE UJIT
DOKUMENTI I RREGULLORES SË VECANTË

LEJE NDËRTIMI PËR OBJEKTIN: "NDËRTIMI I BURIMIT TË RI GJENERUES TË ENERGJISË, HIDROCENTRALIT "NICA" NË PËRROIN E VARRIT TË PLAKËS (RRJEDHIA E SIPËRME E LUMIT SHKUMBIN) BASHKIA POGRADEÇ, QARKU KORÇË", ME SUBJEKT ZHVILLUES SHOQËRINË "JOVA COMPANY" SH.P.K.

MIRATOHET
KRYETAR I K.K.T.U

Z. EDI RAMA

Znj. Belinda BALLUKU

Ministër i Infrastrukturës dhe Energjisë

Miratur me Vendim të KKTU Nr.51, Datë 26.03.2025

Projektues: "INSTITUTI DEKLIADA-ALB" sh.p.k.

Zhvillues : "JOVA COMPANY" sh.p.k.



TABELA E PERMBAJTJES SE DOKUMENTIT TE RREGULLORES SE VECANTE

1.	Dispozita te Pergjithshme.....	3
1.1	Baza Ligjore.....	3
1.2	Pershkrim i zones se studiuar.....	3
2.	Ekstrakte te Planit te Pergjithshem Vendor.....	4
3.	Analiza e Gjendjes Ekzistuese (elementët ekzistues të territorit).....	4
3.1	Informacion për topografinë e zonës.....	4
3.2	Informacion mbi infrastrukturën ekzistuese të zonës për zhvillim dhe zonave përreth saj.....	5
4.	Rregullat e Zhvillimit te Territorit.....	6
4.1	Hapësira e zënë me ndertesa.....	6
4.2	Pamja e jashtme e Godinave/ Trajtimi i fasadave/ Trajtimi i mbulesave.....	7
5.	Rregullat e Rrjeteve te Infrastruktures.....	8
5.1	Pozicionimi i sherbimeve dhe rrjeteve kryesore te infrastrukturave.....	8
5.2	Rrjeti i furnizimit me energji elektrike.....	8
6.	ANEKSE : HARTA E PLANVENDOSJES SE STRUKTURAVE.....	9



1. Dispozita te Pergjithshme

1.1 Baza Ligjore

Kjo rregullore e vecante percakton kushtet e pergjithshme te Lejes se Ndertimit per objektin : “NDËRTIMI I BURIMIT TË RI GJENERUES TË ENERGJISË, HIDROCENTRALIT "NICA" NË PËRROIN E VARRIT TË PLAKËS (RRJEDHIA E SIPËRME E LUMIT SHKUMBIN) BASHKIA POGRADEEC, QARKU KORÇË ”, ME SUBJEKT ZHVILLUES SHOQËRINË “JOVA COMPANY” SH.P.K. bazuar ne bazen ligjore :

- Ligj nr. 107/2014 “Për Planifikimin dhe zhvillimin e Territorit”
- VKM nr.408 date : 13.05.2025 “ Per miratimin e rregullores per zhvillimet ne territor” i ndryshuar
- VKM 591 date : 25.09.2024 “Per shpalljen “Peizazh i mbronjtur” (kategoria V) zonën “Guri i Nikës – Valamarë – Lenie””
- Ligj nr. 81/2017 “Per zonat e mbrojtura” i ndryshuar
- Ligj nr. 21/2024 “Per disa shtesa dhe ndryshim per ligjin nr. 81/2017”
- Kontrata me MIE-n me nr.1135 Rep. , nr.371 Kol. Me date 03.08.2022

1.2 Pershkrim i zones se studiuar

Hidrocentralit “NICA” do të ndërtohet në territorin e bashkise Pogradec , qarku Korçë dhe do të shfrytëzojë ujrë e përroit varri i Plakes, degë e lumit Shkumbin.

Koordinatat e pozicionit gjeografik të hidrocentralit NICA janë si mëposhtë

Hee Nica (KRGJSH)	X	Y
Vepra e marrjes nr 3	539834	4521329
Vepra e marrjes nr 1	539546	4521122
Vepra e marrjes nr 2	540002	4521039
Baseni i Presionit	539587	4521106
Godina e centralit	543467	4521553



Fig 1. Koordinatat HEC NICA

Sipas vendosjes gjeografike, zona e projektit ndodhet në zonën e klimës tranzitore, zonë që është mjaft e përshtatshme për zhvillimin e aktivitetit ekonomik. Këtë avantazh që ofron pozita gjeografike e dëmton karakteri i relievit, i cili në përgjithësi është mjaft i përthyer. Në tërësinë e vet territori i rrethit është një luginë.

Hidrocentrali Nica shfrytëzon ujrat e përroit “Varri i Plakës” ne kuotat 1784 m. mnd dhe përfundon në godinën e centralit në kuoten 1372 m. mnd.



2. Ekstrakte te Planit te Pergjithshem Vendor




Figura 2. Sistemet e propozuara



3. Analiza e Gjendjes Ekzistuese (elementët ekzistues të territorit)

3.1 Informacion për topografinë e zonës

Hidrocentrali planifikohet të jetë i tipit me derivacion dhe do të shfrytëzojë disnivelet e rënies së ujit. Sic dihet, kjo teknologji shfrytëzon ujrat me potencial të ulët teknologjik të burimeve natyrore pa ndryshuar vetitë fiziko-kimike të ujit dhe pa prishur ekuilibret ekologjike në zonën ku do të ndërtohet hidrocentrali.

Hidrocentrali NICA perbehet nga 3 vepra marrjeje, baseni i presionit dhe godina e centralit .

- **Vepra e marrjes nr 1** do te ndertohet ne perroin Varri i Plakes ne kuoten +1780 m m.n.d. Do te jete nje dige nivel-ngritese me lartesi 3.2 m e pajisur me 2 galeri kapese te ujit te tipit tiroleze ne pjesen kaperderdhese te saj dhe nje front kaperderdhese te afte per te shkaktuar prurjet maksimale



- **Vepra e marrjes nr 2** do te ndertohet ne perroin Varri i Plakes ne kuoten +1784 m m.n.d. Do te jete nje dige nivel-ngritese me lartesi 3.12 m e pajisur me 2 galeri kapese te ujit te tipit tiroleze ne pjesen kapenderdhese te saj dhe nje front kapenderdhes te afte per te shkarkuar prurjet maksimale
- **Vepra e marrjes nr 3** do te ndertohet ne perroin Varri i Plakes ne kuoten +1784 m m.n.d. Do te jete nje dige nivel-ngritese me lartesi 3.12 m e pajisur me 2 galeri kapese te ujit te tipit tiroleze ne pjesen kapenderdhese te saj dhe nje front kapenderdhes te afte per te shkarkuar prurjet maksimale
- **Baseni i presionit** do te ndertohet ne fundin e linjes se derivacionit ne kuoten +1778 m m.n.d dhe realizon hyrjen ne kushte te caktuar te prurjes ne tubacionin e turbines.
- Godina e centralit do te ndertohet ne kuoten +1372 m m.n.d dhe do te instalohet nje turbine e tipit Pelton

NICA. Zgjedhja e vendndodhjes së hidrocentralit lejon : -

- Kryerjen e punimeve civile mbi strukturë të sigurtë tektonike dhe gjeologjike
- Marrjen e kuotës optimale të rënies se ujit ($H_{bruto} = 406$ m)

Nuk parashikohen ndërhyrje në rrjetet ekzistuese të infrastrukturës përveç lidhjeve me rrugët hyrëse dhe sistemet teknike.

3.2 Informacion mbi infrastrukturën ekzistuese të zonës për zhvillim dhe zonave përreth saj

Realizimi i këtij projekti së bashku me infrastrukturën rrugore që do të ndërtohen bëhen elementë kyc në infrastrukturën lokale.

Gjatë fazës së shfrytëzimit qarkullimi i automjeteve do të jetë i kufizuar dhe nuk do të përbëjë rrezik sinjifikativ për aksidente. Korridoret e hyrje-daljeve në vepër dhe rrugët komunikuese të objekteve bëhen në vende të përshtatshme pa prishur breza pyjor të bregprroit.


Janë dhe rrugët e aksesit që lidhin nën objektet e hidrocentralit me njëri - tjetrin





4.2 Pamja e jashtme e Godinave/ Trajtimi i fasadave/ Trajtimi i mbulesave.

Ndërtimi i “Hec NICA ”, nuk sjell ndikim negativ në mjedis,dhe as ndikime negative pamore pasi Godina e tij është projektuar në harmoni të plotë me elementët e mjedisit ekzistues.



Pamje 3-Dimensionale te Godines se Centralit Hec NICA



5. Rregullat e Rrjeteve te Infrastruktures

5.1 Pozicionimi i sherbimeve dhe rrjeteve kryesore te infrastrukturave

5.1.1 Rrjeti rrugor

Infrastruktura rrugore zë fill nga rruga nacionale Pogradec – Korce me drejtim për ne Fshatin Kalivac dhe më tej ne fshatin Dunicë dhe në fshatin Trebinjë, më pas janë edhe rrugët e aksesit që shërbejnë për aksesin e objekteve dhe nënobjekteve te hidrocentralit NICA.

5.2 Rrjeti i furnizimit me energji elektrike .

5.2.1 Sistemi i furnizimit të tensionit të mesëm .

Pika e lidhjes me tensionin e mesëm përcaktohet nga prodhuesit e turbinave që mbulon rrjetin shpërndarës të zonës qe kalojnë pranë objektit dhe nga ngarkesa që do të furnizohet me energji elektrike

Linja e tensionit të mesëm që fillon nga pika e lidhjes deri në kabinën transformatorike të objektit mund të ndërtohet ne 2 mënyra : ajrore ose kablllore. Secila nga këto dy mënyra duhet të plotësojë kushtet e zbatimit për linjat e TM të KTZ të Shqipërisë

5.2.2 Sistemi i tokëzimit

Të gjitha aparatet ose pjesët e tyre të lidhura në mënyre josolide me tokëzimet, duhet të jenë të lidhur me një sistem të vetëm tokëzimi, sipas një mënyre të aprovuar nga përcues të fuqishëm të siguruar me anën e mëngave. Aty ku cdo pjesë e pajisjes është e lidhur me një linjë uji, gazi ose lëndë djegëse aparati, duhet të jetë i lidhur me linjën duke përdorur shirit bakri të kallajisur 20 mm x 1.5mm ose tokëzim me izolator PVC. Përgjate instalimeve të linjës edhe të gypave një përcues i ndarë mbrojtës duhet instaluar, lidhur me një linjë të fundme toke ne cdo kuti aksesorësh edhe gypash dhe të instaluara brenda cdo gjatësie te gypit fleksibël .

Megjithatë pajisja e nje përcuesi të ndarë mbrojtës, vazhdimësia e instalimit të tubave edhe linjës kryesore duhet të jetë në të njëjtin standart.



6. ANEKSE : HARTA E PLANVENDOSJES SE STRUKTURAVE

TREGUESIT E ZHVILLIMIT:

Sipërfaqe e ndërtimit të veprës së marrjes nr.1: 120 m²

Sipërfaqe e ndërtimit të veprës së marrjes nr.2: 130 m²

Sipërfaqe e ndërtimit të veprës së marrjes nr.3: 130 m²

Sipërfaqe e ndërtimit të godinës së centralit: 120 m²

Gjurma e Hec NICA vendoset ne parcelat e ekonomise pyjore/kullosore Qaf Panje-Guri Nikes, Nice-Valamare, ne parcela/t nr.38a,57b(10k),56a,53a,48d,49e,49d,50a,51a.

TREGUES TEKNIK:

Hec "NICA"

Kuota e veprës së marrjes nr.1: +1780 m m.n.d

Kuota e veprës së marrjes nr.2: +1784 m m.n.d

Kuota e veprës së marrjes nr.3: +1784 m m.n.d

Kuota e godinës së centralit: +1372 m m.n.d


Gjatësia e tubacionit të presionit: 4066 m

Diametri i tubacionit të presionit: 650 mm

Fuqia e hidrocentralit: 1300 kW

Energjia mesatare vjetore: 2,651,080 kWh/vit





Legjenda

- Koordinatat
- tubacion derivacioni
- tubacion presioni
- veprat


DEKLARATA
TITUTE

Shk 1:14000

Vepra e marries nr 3	539834	4521329
Vepra e marries nr 1	539546	4521122
Vepra e marries nr 2	540002	4521039
Baseni i Presionit	539587	4521106
Godina e centralit	543467	4521553



PLANVENDOSIA NE ORTOFOTO E OBJEKTEVE TE HEC NICA



Vepra e marjës nr 3	539834	4521329
Vepra e marjës nr 1	539546	4521122
Vepra e marjës nr 2	540002	4521039
Baseni i Presionit	539587	4521106
Godina e centralit	543467	4521553

